

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 22, neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi 15 dhe neni 96 paragrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 23 dhe neni 41 paragrafi 1 nënparagrafi 13 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.01-3632/1 datë 22.8.2025, dhe në lidhje me nenin 76-v paragrafi 1, neni 75-gj paragrafi 1, neni 76, neni 76-a paragrafët 2 dhe 8 dhe neni 75 paragrafët 1 dhe 4 të Kodit Zgjedhor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.40/06, 136/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24 dhe 76/24), në pajtim me Konkluzionin nr. 02-4095/2 datë 26.9.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 12-të, mbajtur më 26.9.2025, miratoi:

UDHËZIM PËR RADIODIFUZERËT PËR ZGJEDHJET LOKALE 2025

1. Me këtë Udhëzim shpjegohet mënyra e zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës për reklamat politike me pagesë (RPP), shënjimin e porositesit të reklamimit, ndarjen e kohës në lajme të Shërbimit publik radiodifuziv (SHPR), prezantimin politik pa pagesë të Shërbimit programor të destinuar për emetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Shërbimi i Kuvendit) dhe për sigurimin e qasjes në përmbajtjet e procesit zgjedhor për Zgjedhjet për anëtarët e këshillave komunalë dhe Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët e komunave dhe për kryetarin e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: Zgjedhjet lokale 2025).

Reklamim politik me pagesë

2. Gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, në rrethin e parë të votimit, radiodifuzerët mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) kohë shtesë për reklamim në kohë reale program të emetuar të destinuar ekskluzivisht për reklama politike me pagesë.
3. Në pajtim me ndarjen e kohës për reklamat politike me pagesë të përcaktuar në nenin 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, në total prej nëntë minutash dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) në kohë reale program të emetuar, do të përdoren si në vijim:
 - në maksimum 4 minuta të destunuara për dy partitë politike më të mëdha të pozitës, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputet kanë fituar më së shumti vota, do të emetohet reklama politike me pagesë e partisë politike VMRO DPMNE (Koalicioni Maqedonia yte) dhe partisë politike Lëvizja BESA (Koalicioni VLEN).
 - në maksimum 4 minuta të destinuara për dy partitë më të mëdha politike në opozitë, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputet kanë fituar më së shumti vota, do të emetohet reklama politike me pagesë e partisë politike LSDM (Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025) dhe partisë politike BDI (Aleanca Kombëtare për Integritet – AKI).
 - në maksimum 1 minutë të destinuar për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputet nuk fituan mjaftueshëm deputetë për të formuar grup parlamentar, do të emetohet reklama politike me pagesë e partisë politike LDP (Koalicioni me Përvojë për Sukses), të partisë politike Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni dhe partisë politike Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni.
 - 30 sekondat e mbetura janë destinuar për bartësit e listave që nuk janë përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht për kandidatët nga grupe zgjedhësishe.
4. Koha e lejuar për reklamim ndërmjet bartësve të listave do të ndahet bazuar në një kontratë paraprake me shkrim ndërmjet tyre. Përveç kësaj, secili bartës i listës mundë ta blejë në total kohën e lejuar për RPP të kategorisë së tij (4 minuta/4 minuta/1 minutë/30 sekonda), nëse nuk ka interes nga bartës tjetër i listës dhe nëse kjo është në pajtim me kontratën e arritur.

5. Koha në total për reklama politike me pagesë në kohë reale program i emetuar gjatë fushatës zgjedhore në rrethin e dytë të votimit në Zgjedhjet lokale do të varet nga koha për RPP e përdorur nga bartësit e listave, kandidatët e të cilëve për kryetar bashkie do të vazhdojnë fushatën zgjedhore në rrethin e dytë. Njëkohësisht, ndarja e kohës ndërmejet bartësve të listave do të jetë e njëjtë me atë në rrethin e parë të fushatës zgjedhore.
6. Gjatë lidhjes së kontratave për reklama politike me pagesë dhe emetimin e tyre, radiodifuzerët duhet të marrin parasysh respektimin e limiteve totale të lejuara për orë reale për secilën nga kategoritë e bartësve të listave dhe respektimin e kohës totale të lejuar për RPP për orë reale të programit të emetuar.
7. Sipas nenit 76-v paragrafi 9 të Kodit Zgjedhor, kontratat duhet të përmbajnë informacion të qartë mbi periodhat e reklamave, çmimet e reklamave dhe vlerën e kontratave. Çdo reklamë e emetuar që nuk porositet nga bartësit e listave, përkatësisht që është jashtë përcaktimit të kontratave të lidhura, do të konsiderohet si financim ose për dhënie donacion për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, gjë që nuk lejohet në pajtim me nenin 75 paragrafi 7 të Kodit Zgjedhor.
8. Në pajtim me nenin 76 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, në të gjitha format e reklamimit politik me pagesë, porositësi i reklamës duhet të shënohet (identifikohet) qartë.
9. Si porositës të reklamave duhet të ceken emrat e saktë të listave të konfirmuara të kandidatëve për kryetar bashkie ose për këshill komunal, përkatësisht për Qytetin e Shkupit.
10. Në rastet kur paraqitës i listës së konfirmuar ka vendosur një pjesë të kohës së tij të bler për RPP, ta përdorë për të mbështetur pjesëmarrës të tjerë në fushatën zgjedhore, radiodifuzerët duhet të cekin emrin e saktë të porositësit të reklamimit, dhe jo pjesëmarrësit e mbështetur në fushatën zgjedhore.

Ndarja e kohës në lajmet e SHPR

11. Gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, Shërbimi publik radiodifuziv në lajme do të raportojë si në vijim:
 - në 30% të kohës mbi aktivitete e partive politike në pushtet, do të informojë për fushatën zgjedhore të: VMRO DPMNE (Koalicioni Maqedonia yte), Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lëvizja BESA (Koalicioni VLEN), dhe për Partinë politike Lëvizja Znam – për Maqedoninë tonë;
 - në 30% të kohës mbi aktivitetet e partive politike në opozitë, do të informojë për fushatën zgjedhore të: LSDM (Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025), LDP (Koalicioni me Përvojë për Sukses), BDI (Aleanca Kombëtare për Integritet – AKI), Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni dhe Partisë Politike e Majta;
 - në 10% të kohës do të informojë për aktivitet e partive politike që nuk janë përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për kandidatët e pavarur.

Prezantimi politik pa pagesë i shërbimit të Kuvendit

12. Gjatë rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, Shërbimi i Kuvendit, çdo ditë do të sigurojë gjithsej tre orë për prezantim politik pa pagesë të fushatave të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe gjithsej një orë çdo ditë për prezantim politik pa pagesë të fushatave të bartësve të listave që nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
13. Në total në tre (3) orë gjatë ditës për prezantim politik pa pagesë gjatë rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, do të emetohet prezantim pa pagesë të partive politike: VMRO DPMNE (Koalicioni Maqedonia yte), Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lëvizja BESA (Koalicioni VLEN), Partia politike Lëvizja Znam – për Maqedoninë tonë, LSDM (Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025), LDP (Koalicioni me Përvojë për Sukses), BDI (Aleanca Kombëtare për Integritet – AKI), Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni dhe Partia Politike e Majta. Në rrethin e dytë, gjatë kësaj kohe do të emetohet prezantim pa pagesë të kandidatëve për kryetar bashkie që do të vazhdojnë fushatën zgjedhore në rrethin e dytë.

14. Për mënyrën e përdorimit të kohës për prezantim politik pa pagesë do të vendosë shërbimi programor i destinuar për emetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me politikën editoriale, për të cilën në kohë do t'i informojë pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore.

Qasja në përmbajtjet në lidhje me procesin zgjedhor

15. Shërbimi publik radiodifuziv dhe stacionet televizive në nivel shtetëror që do të publikojnë reklama politike me pagesë, në pajtim me detyrimet nga neni 75 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të Kodit Zgjedhor, përmbajtjet në lidhje me procesin zgjedhor duhet të emetohen në format që qashshëm për personat me aftësi të kufizuara.
16. Shërbimi publik radiodifuziv dhe stacionet televizive në nivel shtetëror do të sigurojnë qasje në:
- së paku një edicioni lajmesh, në periudhën nga ora 16:00 deri në ora 24:00, çdo ditë, dhe të
 - së paku një emisioni tjetër lidhur me fushatën zgjedhore, në periudhën nga ora 16:00 deri në ora 24:00, një herë në javë.

Dispozitat përfundimtare

17. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Udhëzim duhet të kryhen me shkrim.
18. Ky Udhëzim hynë në fuqi me ditën e miratimit, dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Агенција за аудио и аудиовизуелни
медиумски услуги**

**Претседател на Советот,
м-р Сашо СТЕФАНОВСКИ**